REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 46/17
Datë/Datum. 01.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.46/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit.		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim, instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftes në KEK sh.a"**, me nr. prokurimi: **KEK-16/370/111.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE PBC SH.P.K - Prishtinë.**		
Datë	**01.03.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim, instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftes në KEK sh.a"**, me nr. prokurimi: **KEK-16/370/111"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK),** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE "**PBC**" SH.P.K, me seli në Prishtinë, me nr.prot.**46/17**, i datës **16.02.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **"Furnizim, instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftes në KEK sh.a"**, me nr. prokurimi: **KEK-16/370/111,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).**

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		22.02.2017		23.02.2017		01.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 22.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit- 46/17, e parashtruar nga operatori ekonomik "PBC" sh.p.k - Prishtinë. lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim, instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftes në KEK sh.a", me nr. prokurimi: KEK-16/370/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: "PBC" sh.p.k - Prishtinë:

Pikat e Ankesës:
Neni 7, paragrafi 2 i LPP-së,

Neni 28, paragrafi 2 i LPP-së,

Neni 20.4 i Udhëzuesit për Prokurimit public, (UOPP),

Neni 69 i LPP-së,

Neni 108/A i LPP-së,

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 2 të nenin 7, paragrafin 2 te nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. O5/L-068 dhe ligjin Nr. O5/L-O92, dhe paragrafin 20.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, SEPSE:

a. Ka kërkuar pajisje (gjurmuese), specifikacionet e të cilave plotësohen vetëm nga prodhuesi në Turqi (Arvento) dhe ka diskriminuar të gjithë prodhuesit tjerë. Kësi soji,

Autoriteti Kontraktues ka cenuar rëndë dispozitën ligjore të *nenit 7.2 të LPP ku thuhet se: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo*

eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik,

Nenit 28.2 te LPP ku thuhet se: Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Provë: Borshura e prodhuesit Arvento

Përgjigja e prodhuesit se vetëm Arvento i plotëson këto kërkesa:
Kjo i është bërë me dije Autoritetit Kontraktues, nëpërmjet pyetjeve, përkatësisht informacioneve shtesë dhe kërkesës për rishqyrtim, por i njëjti ka refuzuar çfarëdo alternative tjetër. Për më tepër, në vend se Autoriteti Kontraktues t'i bindet provave tona se gabimisht është zbatuar legjislacioni për prokurim publik, i njëjti përgjigjet se Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit plotësohen edhe prej prodhuesit Astra Telematics me modelin AT240 dhe se produkti i ofruar nga ana jonë, në një procedurë paraprake (të anuluar tashmë) i plotëson Kërkesat Teknike. Se kjo nuk qëndron dhe arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është i paqëndrueshëm, në vazhdim po iu bashkangjesim provat, ku dëshmohet se AT240 nuk i plotëson Kërkesat Teknike të Dosjes së Tenderit dhe produkti i ofruar nga ne në procedurë paraprake nuk i plotëson Kërkesat Teknike, sepse në Dosjen e Tenderit, të kësaj procedure, ato janë ndërruar nga Autoriteti Kontraktues.

1. Broshura te AT240 nga Telematics 2. Broshura e produktit (GV2OO) që e kemi ofruar në procedurën paraprake.

b. Autoriteti Kontraktues ka dështuar të përshkruaj Kërkesat Teknike qartë, saktë dhe precize, sikurse kërkohet në nenin 20.4 të RUOPP përkitazi me rezervuarët e derivateve **(llojin, thellësinë, gjerësinë, formën, etj)**, si elemente bazike përmes së cilave do të definoheshin saktë llojet e senzorëve që mundësojnë matjen e sasisë së derivateve, përkatësisht definimin e kostos së blerjes së sensorëve dhe kostos së implementimit të tyre, e as nuk na ka dhënë një listë të saktë të pajisjeve që kanë, përmes së cilës do të gjenim modelet e makinerive në internet, apo tek prodhuesit e tyre dhe do te definonim llojet e rezervuarave dhe do të definonim koston financiare. C'është e vërteta, Autoriteti Kontraktues na ka dërguar një listë të makinerive që ka në dispozicion, por ajo është e mangët, sepse aty shkruan, për shembull Prodhuesi Iveco, lloji i karburantit diesel, viti i prodhimit 1960. Sic dihet, botërisht, këto të dhëna nuk mjaftojnë për ta gjetur modelin e saktë e aq më pak llojin e rezervuarit. Shtesë kësaj, Autoriteti Kontraktues ka mundësuar site visite" dhe personeli ynë ka marrë pjesë në atë sesion, mirëpo nga personat që na kanë shoqëruar (zyrtarë të Autoritetit Kontraktues) nuk na është lejuar matja e sisorëve, por vetëm na kanë mundësuar pamje fizike, nga distanca, e cila, natyrisht që është tepër e pamjaftueshme për të konkluduar llojin e sensorëve të nevojshëm.

Pra, në një përmbledhje të asaj që u tha dhe u dëshmua më sipër, bazueshëm mund të konkludohet se: 1. Autoriteti Kontraktues ka përpiluar specifikime teknike, diskriminuese per pajisjet gjurmuese (GPS), duke ia pamundësuar ofertimin, kujtdo që nuk arrinë të ofroj pajisje të prodhuara nga Arvento e Turqisë, 2. Autoriteti Kontraktues nuk e ka definuar saktë kërkesën për sensora të derivateve e as gjendjen ekzistuese të tyre. Nga kjo rrjedhë se operatorët ekonomik i ekspozohen rrezikut të përpilojnë një ofertë "sy-mbyllurazi" në kuptimin financiar e pas nënshkrimit të kontratës të ballafaqohen me një situatë ku obligohen të investojnë shuma që tejkalojnë shumën e kontratës - pra të krijojnë humbje financiare, ose edhe të heqin dorë nga instalimi i sensorëve në një pjesë të makinerisë ku do të ballafaqohen me

probleme juridike para kontratës.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L- 237, ligjin Nr. O5/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-O92. SEPSE:

c. Autoriteti ka kërkuar kushte dhe kritere të përzgjedhjes që nuk lejohen me nenin në fjalë. Konkretisht, AK ka definuar vlerën (financiare) të kontratës tek Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

Provë 5 : Operatori ekonomik duhet të bashkangjes minimum 1 (një) referencë që dëshmon ekzekutim të mirë te furnizimeve të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (2013.2014 dhe 2015) **me një vlerë të ngjashme.**

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. O5/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, SEPSE:

a. Fare nuk ka nxjerre vendim per pezullimin e aktivitetit te prokurimit,

b. Fare nuk ka nxjerre vendim lidhur me kërkesën tone per ri-shqyrtim, por na e ka

dërguar nje përgjigje te pabazuar, të cilën e kemi kundërshtuar dhe deri në këto momente nuk kemi pranuar ndonjë informatë/vendim/përgjigje nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te Paragafin 20.4 te Rregullave dhe Udhezimit Operativ per Prokurim Publik, SEPSE:

a. Ne besojmë qe AK ka dështuar për te precizuar kërkesën e paraqitur tek Aneksi 1 (

Kërkesa 22), edhe përkundër caktimit te site vizitës, ngase me pjesëmarrjen tone tek

AK, nuk kemi arritur te pranojmë informatën mbi thellësinë dhe gjerësinë e rezervuarit, me c'rast ne kemi kërkuar përsëri ketë informate nga AK përmes te drejtes se kerkeses

per informate shtese, ku përgjigja e AK-se ne ketë rast është strikte Jo, nuk mund të ofrojmë këtë informatë, për këtë arsye edhe kemi organizuar site vizitën, në mënyrë që të gjithë OE të kenë mundësi të marrin informatat e nevojshme në vend të ngjarjes.

Provë. Përgjigjja e AK me numër rendor nr. 1

Nga ajo që shihet dhe, fuqishëm është theksuar më sipër, shihet qartë se ka ndodhur një mal sheljesh ligjore përgjatë përpilimit të kritereve të përzgjedhjes dhe specifikacioneve teknike. Për këtë arsye kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit ta kthej këtë lëndë në RITENDERIM OSE TA

OBLIGOJ AUTORITETIN KONTRAKTUES QE TE BEJE ZGJATJEN E AFATIT TE FUNDIT PER DOREZIMIN E

OFERTAVE T RISHIKOJ TERMAT E REFERENCES DHE TE ELIMINOJ ATO QE DISKRIMINOJNE, TE NA JEP

INFORMACIONE TE MJAFTUESHME PER GJENDJEN EKZISTUESE. LLOJET E REZERVUARVE DHE DIMENSIONET

E INFORMACIONE TJERA, TE CILAT KREJT NE FUNDJANE NE BENEFIT TE VET

AUTORITETIT KONTRAKTUES.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35).. 04.10.2016, njoftimi për informata shtesë përmisim i gabimit.....11.11.2016 *Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-*.....procedur e hapur *Lloji i kontratës së publikuar(N.16):* .....Furnizim/ vlerë e madhe *Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):* .....16.02.2017 *Data e hapjes së ofertave (N.58):*.....Nuk kemi hapje të ofertave Kriter për dhënien e kontratës..... Tenderi përgjegjshëm, çmimi më i lartë

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net. *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042. Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit 2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q . 3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës. **III.2.2 Përshtatshmëria profesionale** ***Kërkesa:*** 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; 3. Rexhistrimi i numrit fiskal Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit); 2. Kopja e TVSH-se;

3. Kopja e numrit fiscal.

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kerkesat:
1. Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentues
2. Pasqyra e projekteve dhe vlera minimale referencave në lidhje me punët ne tri vitet e fundit
3. Katalogje të produkteve, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen, autenticitetit dhe cilësisë reprezentues.
4. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar (të bashkangjitur kopja e marrëveshjes me prodhuesin), për shitjen e produkteve qe ofroni.
2. Operatori ekonomik duhet të bashkangjes minimum 1 (një) referencë që dëshmon ekzekutim të mirë te furnizimeve të natyrës së ngjajshme në tri vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015) me një vlerë të ngjashme.
3. Katalogë ose përshkrimet teknike detale për te gjithë artikujt qe ofertoni. Ne katalogë (specifikim) te nënvizohen artikujt qe keni ofertuar për çdo pozicion te kërkuar ne këtë DT.
1. 4. Kopja e certifikatës ISO 9001:2008 te prodhuesit për produktet e ofruara.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1),

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur e hapur, kontrat për furnizim me vlerë të madhe/, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për kontrat konkretish me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat, të datës 04.10.2016, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues "PBC"sh.p.k., me seli në Prishtinë ka parashtruar ankesë me date 12.02.2017, fillimisht tek Autoriteti kontraktues KEK, ku i njëjti Autoriteti kontraktues KEK, ka bërë refuzimin e ankesës si të pabazuar, ndërsa OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje ankesën e parashtruar në Autoritet kontraktues KEK, ka parashtruar ankes në OSHP me datë 16.02.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni:

Neni 7, paragrafi 2 i LPP-së,

Neni 28, paragrafi 2 i LPP-së,

Neni 20.4 i Udhëzuesit për Prokurimit public, (UOPP),

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **"Furnizim, instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftes në KEK sh.a"**, me nr. prokurimi: **KEK-16/370/111,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).**

Neni 69 i LPP-së,

Neni 108/A i LPP-së, konkretisht OE ankues pretendon se kriteret e FDT-së janë diskriminuese duke favorizuar prodhues të caktuar dhe kufizuar konkurencen për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimin ankimor nr.1,

Eksperti shqyrtues, gjatë ekzaminimit të pretendimeve ankimore si dhe kritereve të dosjes së tenderit në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, vlerëson se ankesa është pjesërisht e bazuar për faktin se :

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket informatave përkitazi me rezervuarët e derivateve (llojin, thellësinë, gjerësinë, formën, etj), si elemente bazike përmes së cilave do të definoheshin saktë llojet e senzorëve që mundësojnë matjen e sasisë së derivateve.

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor për faktin se Autoriteti kontraktues është i obliguar të përpiloj specifikim teknike të saktë në lidhje me paisje (rezervuarët e derivateve), në mënyr që të mundësoj OE-të të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit, të kenë informata të mjaftueshme në lidhje me rezervuaret e derivateve si: **llojin, thellësinë, gjerësinë, formën, etj),** që jane elemente bazike përmes së cilave do të definoheshin saktë llojet e senzorëve që mundësojnë matjen e sasisë së derivateve, poashtu përmes së cilës do të gjenim modelet e makinerive duke definuar prodhuesit e tyre dhe do te definonim llojet e sensoreve adekuat për këto paisje.

Pretendimin ankimor nr.2,

Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor në lidhje me nenin nenin 7, paragrafi 2 dhe nenin 28, par.2 i LPP-së duke u bazuar në atë se Autoritetit kontraktues duhet të përpiloj specifika teknike të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit si dhe Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik, në rastin konkret AK-ja ka përpiluar specifikim teknike ku ka kufizuar qasjen e OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit, duke kufizuar konkurencen.

Pretendimin ankimor nr.3,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 108/A të LPP-së, lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim të vendimit të AK-së dhe pezullimin e aktivitetit të prokurimit, pas parashtrimit të ankesës nga ana e OE ankues,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë, për faktin se Autoriteti kontraktues ka bërë shqyrtimin e kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga ana e OE ankues dhe për të njejtën (ankes) ka nxjerrur vendim me datë 23.11.2016, me nr, prot.2431, për refuzim si të pa-bazuar të kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga ana e OE ankues "PBC".

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUAR ankesën OE "PBC"SH.P.K, me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të obligoj Autoritetin kontraktues që të ANULOJ njoftimin për kontrat të dt.04.10.2016, dhe të RITENDEROJ këtë aktivitet të prokurimit (nese edhe më tutje ka interes për këtë aktivitet të prokurimit), duke vendosur kritere në harmoni me dispozitat e LPP-së, konkretisht në harmoni me nenin 7, 28, 69 të LPP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **"Furnizim, instalimi dhe mirëmbajtja e paisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftes në KEK sh.a"**, me nr. prokurimi: **KEK-16/370/111**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).